

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5847  
E mërkurë, 7 gusht 2019  
çmimi 0.40 €

## Partitë mbajnë sekret planet për koalicione

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ ■ FAQE 4-5

# AAK-ja do të dalë më e votuara

- Nëse Kuvendi nuk shpërndahet më 22 gusht vendi hyn në krizë



Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se nëse Kuvendi nuk do të shpërndahet më 22 gusht vendi do të hyjë në një krizë të thellë. Ai ka thënë se do të ishte mirë që të kishte një konsensus të partive për datën e zgjedhjeve. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka bërë me dije se strukturat partiake pëlqejnë që AAK-ja të garojë e vetme në zgjedhje megjithatë, sipas tij, nuk përjashtohet mundësia e ndonjë koalicioni. Nitaj ka theksuar se nuk janë të mbyllura dyert për partitë me të cilat

Aleanca ka pasur bashkëpunim korrekt. Sidoqoftë, ai nuk beson se do të përsëritet koalicioni PAN edhe nëse LDK-ja dhe LV-ja bëjnë koalicion parazgjedhor. Pavarësisht nëse AAK-ja do të garojë e vetme apo si koalicion, Nitaj ka shprehur optimizëm për fitore



HILLARY CLINTON DHE VAJZA E SAJ BOTOJNË SË SHPEJTI LIBRIN E RI F. 2

AMBASADORI I KOSOVËS VIZITON TOMOR MORINËN NË BURGUN E SHKUPIT F. 2

PO KRIJOHET SHËRBIMI I RI PËR TRAJTIMIN E RASTEVE URGJENTE NEUROLOGJIKE F. 6

VESELI KUJTON DJALIN E AXHËS, ISH-LUFTËTARIN E UÇK-SË, SABIT VESELIN F. 6

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KËRKOJNË FOKUSIM NË KTHIMIN E TRYEZËS SË BISEDIMEVE ME SERBINË

## ShBA-ja nuk e harron dialogun Kosovë - Serbi

Shtetet e Bashkuara të Amerikës sërish ua kanë rikujtuar procesin e dialogut me Serbinë partive politike. Ndonëse këto të fundit janë të zëna me përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare,

ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka kërkuar kthimin në tryezën e bisedimeve me Serbinë. Po ashtu, është paralajmëruar një vizitë e John Boltonit, këshilltarit të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, në



Kosovë dhe Serbi, në fund të muajit gusht apo në fillim të shtatorit ■ FAQE 3



### EKONOMI

ARKEP-I: 'Z- MOBILE' TË MOS VENDOSË NË TREG SIM KARTELA TË REJA F. 9

KOSOVA, 'DY' BUXHETE F. 9

### SPORT

FERONIKELI DHE GJASHTË KLUBET E TJERA NËDËRROJNË TRAJNERËT F. 12

**Vetëvendosja: Kriza në shëndetësi kërkon adresim urgjent** ■ FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijibiznesi.com](http://www.kolegijibiznesi.com)  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Ambasadori i Kosovës viziton Tomor Morinën në burgun e Shkupit

SHKUP, 6 GUSHT (ER) - Ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka vizituar të martën në Shkup ish-ushtarin e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, Tomor Morina. Ai është arrestuar nga policia maqedonase më 24 korrik, bazuar në një fletarrestim të "Interpol"-it, të lëshuar me

kërkesë të Serbisë. "Tomori ishte shumë mirë, i qetë, ndihej plotësisht i pafajshëm, dinjitoz si dhe optimist, në pritje të lirimit, ngaqë drejtësia është në anën e

tij dhe presim që shumë shpejt, do të kthehet në familjen e tij dhe në Kosovë!", ka thënë Dedaj përmes një postimi në llogarinë e vet "Facebook".



## Shtator 'i nxehtë' për Kuvendin e Shqipërisë, 33 nisma presin kartonët e deputetëve

TIRANË, 6 GUSHT - Kuvendi i Shqipërisë do t'i fillojë punimet më 2 shtator dhe veç temave që mund të hapë sesioni i ri politik, nga korriku janë mbartur 20 projektligje dhe 13 projektvendime që presin kartonët jeshilë të deputetëve. Reforma zgjedhore ka nisur që në vitin 2017. Ky është sesioni i gjashtë i pritjes. Kjo reformë është parashikuar të mbyllet më 28 nëntor të vitit të kaluar dhe nga aty shpresohej të nënshkruhej marrëveshja e re politike, por deri tani nuk ka asnjë shenjë përparimi.

Paketa anti-shpifje, një iniciativë e drejtpërdrejtë e kryeministrit që ka hapur debat jo vetëm brenda vendit, por ka nxitur edhe kritikën e OSBE-së, pritet të kalojë me dy ligje që do të hapin shumë konflikte: atë për komunikimet elektronike e postare

dhe ligji për medien audiovizive. Një tjetër pikë e nxehtë e shtyrë për në shtator është ai për krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare që hapi debat publik se mund të ndikonte në një rritje të menjëhershme të çmimit të naftës për konsumatorët, e për këtë mazhoranca u tërhoq përkohësisht.

Mes ligjeve është në pritje një nismë e 30 deputetëve socialistë nga qershori i vitit 2016 për krijimin e Institutit të Studimeve për Kujtesën e Luftës së Dytë Botërore.

Projektvendime në pritje të votimit janë 13 sosh. Më i rëndësishmi është shkarkimi i presidentit. Komisioni hetimor ka marrë kohë deri më 3 tetor.


Ndërsa përballja me Metën vijon edhe me tri dekrete që presidenti i ka dërguar për votim



Kuvendit: 1. Zgjedhja e Petraq Milos kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit; 2. Ligji i Kadastrës i kthyer për rishqyrtim dhe 3. Ligji

për Noterinë. Socialistët, po ashtu, do të duhet të vendosin për shkarkimin e Arben Malajt anëtar i Këshillit

Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe për plotësimin e vendeve bosh në bordet e disa institucioneve.



## Presidenti Meta: E vetmja zgjidhje janë zgjedhjet

TIRANË, 6 GUSHT (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar të martën për situatën e krijuar politike në Shqipëri. Ai ka thënë se e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet. "E vetmja zgjidhje janë zgjedhjet. Pa zgjedhje nuk ka demokraci. Pa demokraci nuk ka drejtësi të pavarur. Pa të dyja së bashku nuk ka të drejta

dhe ekonomi për të gjithë shqiptarët. Dhe as ndëshkim për politikanët. Moszgjidhja i shërben vetëm pakicës që nuk njeh rotacion dhe nuk e do hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, pasi ka për të humbur gradualisht pushtetin e paligjshëm politik, ekonomik dhe mediatic. 18 tetori po afrohet", ka shkruar Meta.

## Hillary Clinton dhe vajza e saj botojnë së shpejti librin e ri

WASHINGTON, 6 GUSHT - Hillary Clinton dhe vajza e saj Chelsea Clinton kanë bashkuar forcat në "Librin e grave të guximshme", që nderon gratë, duke nisur nga shkencëtarja Marie Curie e deri tek aktivistja për klimë, Greta Thunberg. Shtëpia botuese "Simon & Schuster" ka njoftuar se libri do të dalë në shitje më 1 tetor. Kjo është hera e parë që ish-sekretarja amerikane e Shtetit dhe kandi-

datja presidenciale ka shkruar një libër me vajzën e saj, ndonëse të dyja më parë kanë publikuar libra ndaras. "Libri i grave të guximshme" përfshin portrete të më shumë se 100 grave, duke përfshirë kandidatën presidenciale Shirley Chisholm, aktivisten saudite Manal al-Sharif, si dhe autoren e emisionit televiziv, Ellen DeGeneres. "Për ne, të gjitha janë gra të guximshme, lidere që kanë kurajë për të bërë

pyetje të vështira dhe që kryejnë punë. Ky libër është vazhdimësi e një bisede që Chelsea dhe unë kemi bërë prej kur ajo ka qenë vajzë e vogël dhe jemi të lumtur që edhe të tjerët të përfshihen në këtë bisedë", ka thënë Hillary Clinton përmes një deklarate. Chelsea në anën tjetër ka thënë se gratë e përfshira në libër "janë tejet optimiste dhe puna dhe jeta e tyre do të bëjë ndryshim në botë".





Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kërkojnë fokusim në kthimin e tryezës së bisedimeve me Serbinë

## ShBA-ja nuk e harron dialogun Kosovë - Serbi

Shtetet e Bashkuara të Amerikës sërish ua kanë rikujtuar procesin e dialogut me Serbinë partive politike. Ndonëse këto të fundit janë të zëna me përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka kërkuar kthimin në tryezën e bisedimeve me Serbinë. Po ashtu, është paralajmëruar një vizitë e John Boltonit, këshilltarit i presidentit të ShBA-së, Donald Trump, në Kosovë dhe Serbi, në fund të muajit gusht apo në fillim të shtatorit



të këshillimit me kryeministrin në procesin e dialogut", është shprehur ai.

Edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, e ka vlerësuar të dëmshëm bllokimin e procesit të dialogut. "Bllokimi i negociatave është problem shumë serioz diplomatik. Bllokimi i bënë të gjitha palët të tërhiqen. Në teorinë dhe praktikën e negociatave thuhet se është më mirë të mos i nisësh negociatat sesa t'i nisësh dhe t'i bllokosh ato, sepse bllokimi i negociatave krijon shkallë të lartë mosbesimi midis palëve negociuese, por ndonjëherë edhe për palët e treta ose ndërmjetësuese", ka deklaruar Bashkurti për gazetën "Epoka e re", duke shtuar se bllokimi i procesit mundëson edhe interferimin negativ të palave të treta. "Bllokimi i negociatave nxitë, gjithashtu, edhe faktorët jashtë negociatorë për të ndërhyrë në proces ose për të reflektuar rreth tij, çka e komplikon më shumë negociimin dhe rritë gjasat për zgjatjen e bllokimit të tij për një kohë të gjatë dhe të paqartë", është shprehur ai. Serbia është tërhequr nga dialogu për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën, pasi Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar vendosi taksën ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Ndonëse skena politike në vend është e zënë me debatin rreth zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që pritet të mbahen së shpejti, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk e harrojnë dialogun Kosovë - Serbi, duke ua kujtuar partive dhe institucioneve të Kosovës kthimin në tryezën e dialogut me Serbinë.

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka zhvilluar të hënën një takim me kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, të cilit i ka rikujtuar se Kosova duhet ta ruajë fokusin në kthimin e tryezës së dialogut. "Ambasadori Kosnett theksoi se është e rëndësishme që Kosova ta ruajë fokusin e vet në

fuqizimin e sundimit të ligjit, kthimit në tryezën e bisedimeve me Serbinë, për të arritur normalizim dhe për të krijuar mundësi të cilat u lejojnë qytetarëve të Kosovës të kontribuojnë në prosperitetin e Kosovës", është thënë në komunikatën për medie të LDK-së.

Në anën tjetër, medet serbe kanë paralajmëruar një vizitë të John Boltonit, këshilltarit të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, në fund të këtij muaji.

Sipas gazetës serbe "Blic", Boltoni pritet të qëndrojë në Prishtinë dhe Beograd në fund të gushtit, ose në fillim të shtatorit. Sipas kësaj gazete, ShBA-ja do ta nisë një ofensivë diplomatike për zgjidhjen e problemit Kosovë - Serbi, duke rifilluar dialogun.

Duke cituar burimet diplomatike,

kjo gazetë vlerëson se kjo varet nëse Prishtina do ta heqë taksën 100 për qind për mallrat serbe. "Nëse ka një garanci që taksë do të hiqet, ai do të vijë. Përndryshe, vizita e tij nuk do të ndodhë, sepse ai thjesht nuk dëshiron të jetë i pasuksesshëm. Meqenëse situata me taksën nuk është e sigurt tani për tani, vizita nuk është konfirmuar", i ka thënë ky burim së përditshmes serbe.

Por, në Prishtinë të gjitha partitë politike kanë bërë me dije se taksë ndaj produkteve serbe duhet të mbetet në fuqi.

Përveç përfaqësuesve të koalicionit PAN, që janë pro vazhdimin të taksës, këtë qëndrim po e përkrahin dhe përfaqësuesit e opozitës. Së fundi, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka bërë me dije se taksë nuk duhet të hiqet derisa të

reflektojë Serbia ndaj shtetit të Kosovës. "Taksë duhet të vazhdojë derisa Serbia të mos ndërrojë qëndrimet e veta dhe përderisa mos të reflektojë në të gjitha këto sjellje të bllokadës që po i bën Kosovës, edhe në njohjet ndërkombëtare, edhe në ç'njohjet, por edhe në çështjet, të themi të përditshme, siç është lëvizja e lirë e qytetarëve, transporti i mallrave dhe çështjet e tjera që ne i kemi diskutuar në Bruksel. Janë arritur marrëveshje, por Serbia nuk po i zbaton", ka thënë Mustafa për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, këtë proces duhet ta udhëheqë kryeministri i ardhshëm i Kosovës. "Gjykata e ka përcaktuar kush, do të thotë është kryeministri, është qeveria që e ka barrën ta bëjë këtë, ndërkaq presidenti e ka rolin e vet

## Kurti: Opozita me një koalicion të përbashkët mund t'i fitojë 70 deputetë

**PRISHTINË, 6 GUSHT (ER)** - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë se në këtë vjeshtë do të ketë pranverë pasi, sipas tij, ardhmëria nuk ka qenë kurrë më afër. "Koha që u ka mbetur është vonesa që e shkaktojnë. Dikur ajo matej me muaj, tash me javë e, së shpejti, veçse me ditë të numërueshme. Ardhmëria kurrë nuk ka qenë më afër. Meqë 22 gushti u la për shpërndarjen e Kuvendit, i bie që zgjedhjet e reja të jenë me 22 apo 29 shtator, ose 6 tetor. Pra, do të kemi pranverë në vjeshtë. Fitorja jonë në këto zgjedhje e fut shpresën në zemrat e qytetarëve për ta nxjerrë shtetin nga kriza e dështimi", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai është shprehur pro koalicionit parazgjedhor me LDK-në duke thënë se një koalicion i tillë mund t'i fitojë 70 deputetë. "Duhet të fitojmë e do të fitojmë. Mirëpo, kësaj radhe është e mundur që të fitojmë edhe para zgjedhjeve. Po, mund të fitojmë pas zgjedhjeve, kur në natën e



raportimeve të komisionarëve nga vendvotimet, ankthi na

bëhet festë. Ama mund të fitojmë edhe para zgjedhjeve këtë

herë. Koalicioni paraprak i opozitës së vërtetë të deridjeshme të

bëhet qeveri e mirë e së nesërme. Asisoj t'i kemi së paku 70 deputetë. Një partner i vogël pas zgjedhjeve do të ishte më shumë se i mjaftueshëm për shumicën absolute të 2/3 dhe gjithësi i panevojshëm për shumicën e thjeshtë qeveritare", ka deklaruar Kurti duke shtuar se mund të fitojnë edhe pa betejë. "Mbase më mirë ashtu, sepse betejat e vërteta e të mëdha do t'i kemi pikërisht pas fitores. Sepse menjëherë duhet të ndryshojnë lajmet e mbrëmjes me qeverisjen tonë të re. Jo me skandale qeveritare, por luftim i kimit dhe korrupsionit. Jo më emigrim pors i eksod, por punësim pa diskriminim. E kështu me radhë...", është shprehur Kurti.

**>> SHPALLJE <<**

► Floriana Cikaqi shpalle të pavlefshëm dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Remzi Ademaj" Prizren.



Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

# AAK-ja do të dal



## - Nëse Kuvendi nuk shpërndahet më 22 gusht vendi hyn në krizë

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se nëse Kuvendi nuk do të shpërndahet më 22 gusht vendi do të hyjë në një krizë të thellë. Ai ka thënë se do të ishte mirë që të kishte një konsensus të partive për datën e zgjedhjeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka bërë me dije se strukturat partiake pëlqejnë që AAK-ja të garojë e vetme në zgjedhje megjithatë, sipas tij, nuk përjashtohet mundësia e ndonjë koalicioni. Nitaj ka theksuar se nuk janë të mbyllura dyert për partitë me të cilat Aleanca ka pasur bashkëpunim korrekt. Sidoqoftë, ai nuk beson se do të përsëritet koalicioni PAN edhe nëse LDK-ja dhe LV-ja bëjnë koalicion parazgjedhor. Pavarësisht nëse AAK-ja do të garojë e vetme apo si koalicion, Nitaj ka shprehur optimizëm për fitore

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 GUSHT - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se për këtë parti është e pakuptueshme pse nuk është caktuar ndonjë datë më e afërt për shpërndarjen e Kuvendit të

Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se nëse më 22 gusht nuk do të shpërndahet Kuvendi, atëherë vendi do të futej në një krizë të thellë. "Seanca për shpërndarjen e Kuvendit është brenda logjikës. Është mirë që ka ndodhur. Ishte pak e pakuptueshme për neve se

pse nuk është caktuar ndonjë datë më e afërt. Pyetja juaj për gjasat që të mos shpërndahet Kuvendi është hipotetike. Unë nuk e besoj se mund të ndodhë një skenar i tillë. Ose, më saktë, nëse mund të ketë skenar të tillë, atëherë vendi do të futej në një krizë të thellë dhe vështirë që dikush mund ta marrë rrezikun

e një loje kaq të rrezikshme", ka deklaruar ai, duke shtuar se do të ishte mirë që të kishte një konsensus të partive për datën e zgjedhjeve. "Nga momenti i shpërndarjes së Kuvendit fillon tik-taku kushtetues i afatit për zgjedhje që është 30-45 ditë. Për ne mjafton të respektohet ky afat kushtetues. Nuk besoj se kjo çështje do të jetë problematike. Do të ishte mirë që të kishte një konsensus të partive për datën e zgjedhjeve. Nëse jo, presidenti duhet ta caktojë datën brenda afatit kushtetues", është shprehur Nitaj.

Ai ka bërë me dije se strukturat drejtuese të partisë pëlqejnë që AAK-ja të garojë e vetme në këto zgjedhje, megjithatë Nitaj ka thënë se nuk përjashtohet as mundësia e ndonjë koalicioni nëse do të vlerësohej si i domosdoshëm. "Vullneti i strukturave drejtuese të partisë kryesisht është që të shkohet vetëm në këto zgjedhje. Ka shumë arsye për këtë, por kryesorja është që bile katër partitë më të mëdha ta

dëshmojnë fuqinë e tyre elektorale si të vetme. Por, nuk përjashtohet as mundësia e ndonjë koalicioni nëse do të vlerësohej si i domosdoshëm", ka theksuar ai.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk janë të mbyllura dyert për partitë me të cilat Aleanca ka pasur bashkëpunim korrekt. "E thashë që shumica nga strukturat drejtuese në parti, duke përfshirë edhe degët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i kanë dhënë një përparësi garës vetëm, por nuk janë mbyllur dyert për partitë me të cilat kemi pasur bashkëpunim korrekt. Sigurisht në mesin e tyre janë partitë që i ka përmendur kryeministri Haradinaj", ka thënë Nitaj.

Mirëpo ai nuk beson se do të përsëritet koalicioni PAN edhe nëse LDK-ja dhe LV-ja bëjnë koalicion parazgjedhor. "Jo, nuk e besoj", ka thënë Nitaj kur është pyetur nëse do të mund të ketë përsëritje të koalicionit PAN. Pavarësisht nëse Aleanca do të



# ë më e votuara

**"Epoka e re":** Në rast se Kuvendi shpërndahet, zgjedhjet pritet të mbahen në fund të shtatorit ose në fillim të tetorit. Është e pranueshme për AAK-në kjo periudhë?

**Nitaj:** Nga çasti i shpërndarjes së Kuvendit fillon tik-taku kushtetues i afatit për zgjedhje që është 30-45 ditë. Për ne mjafton të respektohet ky afat kushtetues. Nuk besoj se kjo çështje do të jetë problematike. Do të ishte mirë që të kishte një konsensus të partive për datën e zgjedhjeve; nëse jo, presidenti duhet ta caktojë datën brenda afatit kushtetues.

**"Epoka e re":** Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) do të garojë e vetme në këto zgjedhje apo do të bëjë koalicionë parazgjedhore?

**Nitaj:** Vullneti i strukturave drejtuese të partisë kryesisht është që të shkohet vetëm në këto zgjedhje. Ka shumë arsye për këtë, por kryesorja është që bile katër partitë më të mëdha ta dëshmojnë fuqinë e tyre elektorale si të vetme. Por, nuk përjashtohet as mundësia e ndonjë koalicioni nëse do të vlerësohej i domosdoshëm.

**"Epoka e re":** Në fakt, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se është i hapur për partneritet me Nismën, AKR-në dhe PSD-në. Elektorati mund ta presë një koalicion të tillë parazgjedhor?

**Nitaj:** E thashë që shumica nga strukturat drejtuese në parti, duke përfshirë edhe degët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i kanë dhënë një përparësi garës vetëm, por nuk janë mbyllur dyert për partitë me të cilat kemi pasur një bashkëpunim korrekt. Sigurisht në mesin e tyre janë partitë që i ka përmendur kryeministri Haradinaj.

**"Epoka e re":** Është përfolur mundësia që LDK-ja dhe LV-ja të shkojnë me një listë të përbashkët në zgjedhjet e parakohshme. Nëse ndodh një gjë e tillë, mund të përsëritet koalicioni PAN?

**Nitaj:** Jo, nuk e besoj.

**"Epoka e re":** Pavarësisht nëse AAK-ja garon e vetme apo si koalicion, cilat janë pritet të juaja për këto zgjedhje?

**Nitaj:** Janë më të mëdha se asnjëherë më parë. Nga sondazhet që kanë dalë dhe nga matjet që i kemi bërë edhe ne si parti, jemi konkurrent serioz për t'i fituar zgjedhjet. Unë s'para prognozohet lehtë, por këtë herë besoj fort në fitoren e AAK-së.

## Partitë mbajnë sekret planet për koalicionë

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Partitë politike në Kosovë kanë filluar t'i bëjnë kalkulimet për koalicionë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që pritet të caktohen pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës më 22 gusht. Por, asnjëra prej tyre nuk ka treguar se me kënd do të bëjë koalicion dhe nëse do të ketë bashkim të tyre para se të mbahen zgjedhjet.

Analistë të çështjeve politike japin mendime të ndryshme rreth krijimit të koalicionëve parazgjedhore si formë e përgatitjes për ta marrë pushtetin. Imer Mushkolaj, analist i çështjeve politike, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se zgjedhjet e parakohshme parlamentare që pritet të shpallen mund të ketë koalicionë parazgjedhore, por jo të partive të mëdha politike. "Pres që Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Vetëvendosja të shkojnë vetëm në zgjedhje, ndërkohë që nuk e përjashtoj mundësinë e një koalicioni ndërmjet Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Partisë Socialdemokrate dhe Aleancës Kosovare e Re, ndërkaq Nisma Socialdemokrate nuk jam i sigurt se mund t'u bashkohet këtyre të fundit, por nuk përjashtohet mundësia t'i bashkohet edhe PDK-së", ka theksuar Mushkolaj.

Në koalicionet e mundshme ndërmjet partive politike,

thotë Mushkolaj, hyn në kombinim edhe presioni ndërkom-bëtar për të krijuar një koalicion i cili mund të shtyjë përpara procese të cilat nuk janë arritur të bëhen deri më tani. Ai ka shtuar se zgjedhjet në Kosovë prodhojnë edhe koalicionë të papritura në kuptimin, siç thotë ai, shpeshherë deri më tani ka ndodhur që në koalicion të hyjnë partitë të cilat paraprakisht qytetarët nuk e kanë pasur idenë se mund të bëhen bashkë.

Ndërkaq sa iu përket koalicionëve paszgjedhore, Mushkolaj thotë se është vështirë të parashikohet se kush me kënd mund të bëjë koalicion pasi që, sipas tij, ajo varet nga rezultati i zgjedhjeve. "Sidomos në dy mandatet qeverisëse vendi ka mbetur peng i këtyre koalicionëve që do të duhej të kryenin punë të mëdha, por që realisht janë ndaluar në gjysmë dhe nuk kanë kryer këto punë të mëdha që është dashur të kryhen. Janë disa tema në tavolinë që partitë politike duhet t'i prekin dhe është sfida për të gjithë që do ta marrin qeverisjen që t'i çojnë përpara në radhë të parë në aspektin politik, dialogu me Serbinë i cili duhet të përmbillet në një afat optimal", ka thënë Mushkolaj.

Një koalicion të mundshëm të partive të mëdha politike në zgjedhjet parlamentare që mund të mbahen këtë vit në

Kosovë e parasheh analisti i çështjeve politike Taulant Kryeziu. "Ende mbetet për t'u qartësuar, por nga ajo çka kam parë unë dhe nëse merren për bazë qëndrimet që kanë pasur në procesin e dialogut, ka një afërsi në këtë pikë në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Vetëvendosjes. Për partitë e tjera ne kemi parë Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës e cila me disa qëndrime dhe deklarime thotë se do të jetë e vetme në zgjedhje, por deri në momentin e fundit asnjëherë nga partitë politike të cilat kanë qenë në pushtet nuk i dihet se si do të vendosin, a do të hyjnë të vetme apo do të tentojnë të ndërtojnë koalicionë", ka deklaruar Kryeziu. Deri më tani një pretendim për koalicion ka shfaqur Lëvizja Vetëvendosje e cila e ka ftuar Lidhjen Demokratike të Kosovës për bashkim. Por, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se partia që ai udhëheq dëshiron të shkojë e vetme në zgjedhje e që, sipas tij, ky qëndrim mund të ndryshojë dhe varet se si veprojnë partitë e tjera. Disa prej anëtarëve të PDK-së janë deklaruar se kjo parti do të garojë e vetme në zgjedhje, ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se ndiejnë një afërsi me partinë Nisma, PSD, AKR dhe ndonjë parti tjetër.

garojë e vetme apo si koalicion, Nitaj ka shprehur optimizëm për fitore. Ai ka thënë se pritet të jetë më të mëdha se asnjëherë më parë dhe se AAK-ja është konkurrenca serioze për t'i fituar zgjedhjet.

**"Epoka e re":** Z. Nitaj, më 22 gusht është caktuar seanca për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Si e komentoni këtë vendim dhe sa ka gjasa që të ndryshojë ky skenar, pra të mos ndodhë shpërndarja e Kuvendit?

**Nitaj:** Seanca për shpërndarjen e Kuvendit është brenda logjikës. Është mirë që ka ndodhur. Ishte pak e pakuptueshme për neve se pse nuk është caktuar ndonjë datë më e afërt. Pyetja juaj për gjasat që të mos shpërndahet Kuvendi është hipotetike. Unë nuk besoj se mund të ndodhë një skenar i tillë. Ose, më saktë, nëse mund të ketë skenar të tillë, atëherë vendi do të futej në një krizë të thellë dhe vështirë që dikush mund ta marrë rrezikun e një loje kaq të rrezikshme.





## Themelohet Qendra për Zhvillim të Karrierës në Universitetin "Isa Boletini"

MITROVICË, 6 GUSHT (ER) - Me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) është themeluar Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK). Qendra fillimisht do të funksionojë në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun.

Rektori Alush Musaj ka thënë se themelimi i Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZHK), në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", është një projekt tepër i rëndësishëm për studentët

dhe vetë universitetin. "Një qendër e tillë do të jetë një pikë e rëndësishme informacioni dhe ndërmjetësi për studentët", ka thënë Musaj. Ndërsa drejtori për Informim dhe Komunikim me Publikun, Ahmet Jashari, ka thënë se kjo qendër do ta ndihmojë rritjen e prestigjit të UMIB-it dhe do të krijojë mundësi për thithje të granteve dhe donacioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me vetë qendrën, mirëpo edhe vetë universitetin. "QZHK-ja do t'i ndihmojë studentët e Universitetit të

Mitrovicës 'Isa Boletini' sa i përket zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive që do t'u ndihmojnë për punësim, ofrim të mundësisë për studentët që të fitojnë përvojë pune gjatë studimeve, ofrim të informatave për tregun e punës, ofrim të mundësisë për qasje në informata për studime, trajnime, seminare, ligjërata dhe aktivitete të tjera", ka thënë ai.

QZHK-ja do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive, njohurive dhe shkathtësive, të cilat janë kyçe për procesin e



punësimit të studentëve dhe të diplomuarve. Po ashtu, e njëjta do të ofrojë shërbime të

digjitalizuara për edukim, këshillim, zhvillim dhe orientim në karrierë etj.

## Po krijohet shërbimi i ri për trajtimin e rasteve urgjente neurologjike

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Në Klinikën e Neurologjisë kanë filluar punimet për rinovimin dhe modernizimin e hapësirave për pacientë. Këtë klinikë e ka vizituar drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, i cili për së afërmi është njoftuar në lidhje me punën që po bëhet për rinovim të hapësirave. Ai ka bërë me dije se në kuadër të

projektit për modernizim të hapësirave të klinikave të QKUK-së pritet që të krijohet shërbimi i ri për trajtimin e rasteve urgjente neurologjike, të njohura si sulme iskemike të trurit (ICV), e që do të bëhen të mundura me krijimin e "Stroke Center".

Në këtë qendër do të vendoset edhe Rezonanca e re Magnetike dhe Tomografia e Kompjuterizuar (CT) e që, përveçse do të shërbejnë për trajtim të rasteve urgjente neurologjike, do të mundësojnë që

listat e pritjes për këto shërbime të zvogëlohen dukshëm. Drejtori Sejdiu ka njoftuar se në Klinikën e Neurologjisë do të bëhet ndarja e pacientëve ambulatorë nga ata spitalorë ngaqë ambulancat specialiste do të funksionojnë ndaras nga pjesa spitalore. Po ashtu, do të krijohet recepsioni në të cilin do të paraqiten, regjistrohen dhe drejtohen pacientët. Projekti parasheh edhe rinovimin e mjekimit intensiv dhe krijimin e kushteve moderne për pacientë.



## Veseli kujton djalin e axhës, ish-luftëtarin e UÇK-së, Sabit Veselin

MITROVICË, 6 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë nderime të martën pranë varrit të Sabit Veseli, një prej veprimtarëve të hershëm për liri dhe pavarësi dhe ish-luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sabit Veseli. "Sa herë vjen 6 gushti, bashkë me shokët e bashkëlufetarët tanë ngjitem në

kodrën e varreve mbi Broboniq, për të të nderuar ty vëlla Sabit. Na bashkonte gjaku, por më shumë ëndrra për liri, së cilës ia kushtove gjithë jetën. Do të të kujtojmë e nderojmë gjithmonë, ashtu siç ti gjithë jetën, me veprën tënde, e nderove Kosovën", ka shkruar ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".

## "Shota", e dyta në festivalin më të madh të folklorit në botë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota" ka arritur ta fitojë çmimin e dytë në festivalin më të madh të folklorit në botë "Buyukçekmece Kulture ve Sanat Festivali" (Festivali Ndërkombëtar i Kulturës dhe Arteve) në Turqi.

Ansambli "Shota" ka përsëritur suksesin e vitit 2013 kur, po ashtu, kishte fituar çmimin e dytë në këtë festival, por tani në një

konkurrencë dukshëm më të fortë, duke marrë parasysh që në edicionin jubilar të 20 të këtij festivali, këtë çmim e ka marrë në garën ku kanë konkurruar 28 shtete nga mbarë bota.

Marrë parasysh se ansambli ka udhëtuar në Turqi, me disa mungesa në orkestër dhe grupin e valltarëve, ky është sukses shumë i madh, edhe për faktin se në këtë festival kanë garuar shtete me ansamble shumë seri-

oze nga Rusia, Gjeorgjia, Ukraina, Bullgaria, Spanja, Serbia, Kroacia, Hungaria, Panamaja, India etj. Vendin e parë dhe çmimin "Ura e Artë" e Mimar Sinanit e kanë ndarë dy ansamble nga Rusia dhe Hungaria, ndërkaq vendin e tretë e ka fituar ansambli nga Gjeorgjia. Krahas pllakatit të argjendtë, për vendin e dytë Ansambli ka marrë edhe shpërbllim material në vlerë prej 2 000 dollarësh amerikanë.





# Vetëvendosja: Kriza në shëndetësi kërkon adresim urgjent

Zgjedhjet e jashtëzakonshme janë të domosdoshme për Kosovën sepse i dhënë fund keqeverisjes në shëndetësi. Kështu kanë deklaruar të martën zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Arben Vitia dhe Baton Kelmendi, në një konferencë për medie. Ata kanë vlerësuar se kriza në shëndetësi kërkon adresim urgjent

**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Arben Vitia dhe Baton Kelmendi, të martën kanë mbajtur konferencë për medie, në të cilën kanë folur për sistemin e shëndetësisë. Ata kanë thënë se kriza në shëndetësi kërkon adresim urgjent. Zyrtari i kësaj lëvizje, Arben Vitia, ka thënë se zgjedhjet e jashtëzakonshme janë të domosdoshme për Kosovën dhe, sipas tij, kështu edhe i jepet fund keqeverisjes në shëndetësi. "Instrumenti që përdoret për ta zbatuar këtë strategji

të mbapshtë është edhe sistemi i prokurimit. Kështu po shkaktohen padrejtësi të shumëfishta karshi pacientëve të cilëve u pamundësohet trajtimi i dinjitetshëm, stafit shëndetësor, të cilëve u është kthyer në sfidë puna e përditshme në mungesë të mjeteve bazike, kompanive të specializuara të cilave u është mohuar puna nëse nuk japin rishfetin e kërkuar", është shprehur Vitia, duke shtuar se raste që e ilustron këtë fenomen ka shumë, por ai ka përmendur rastin e furnizimit me stenta, të blerjes së shtretërve dhe të hemodializës. "Aty janë shpërbly-

er kompani të cilat nuk garantojnë minimumin e cilësisë përmes certifikatave bazike. Janë blerë stenta të cilat, sipas dokumentacionit, nuk garantojnë cilësinë e duhur. Paramendoni, 'stenta' vendoset në arteriet koronare në zemër e pacientit. Ato nuk e kanë të garantuar cilësinë dhe sigurinë përmes certifikimeve. Rasti i furnizimit me shtretër për pacientët. Janë porositur mbi 700 shtretër për persona me peshë deri në 300 kg. Standardi është maksimumi deri në 250 kg. Ky furnizim shkaktoi situata komike, pasi dyert nuk kishin dimensionet e shtretërve. Tragjik mbetet fakti se në fund pacientët mbesin pa shtretër, kurse blerja e tyre është bërë mbi vlerën reale të tregut. Bëhet fjalë për mbi një milion euro", ka theksuar ai. Më tutje, Vitia ka deklaruar se simulohet një situatë emergjente e furnizimit për produktet e hemodializës, shfrytëzohet për tenderë me procedurë

emergjente të negociuar. "I jepet tenderi një kompanie të formuar në kohën e qeverisë së rrëzuar tashmë. Rastësia e sjell që kompania ka për themelues dy persona të afërt me ish-qeverinë. Domethënë, produkte shumë të nevojshme dhe delikate të cilat futen në organizmin e njeriut, fillimisht rrezikohet të mbetet pa to për shkak të mungesës së planifikimit, pastaj përmes një procedure emergjente që lë për të dëshiruar, blihen me çmime edhe më të larta", ka thënë ai, duke shtuar se këto mund të evitohen sikur të ishte funksionalizuar sistemi informativ shëndetësor por, sipas tij, këtë sistem e kanë dështuar po të njëjtët përkundër investimeve milionëshe. Për të dëshmuar konkretisht se me çfarë përballesh mjekët brenda QKUK-së doktor Baton Kelmendi ka shpjeguar sfidat e përditshme për pacientët e mjekët. "Situata në Qendrën Klinike Universitare është shembulli më përfaqësues

ku cinizmi ka mbërritur deri aty sa marketingu personal i ish-ministrit Ismajli merret me përrime të punëve që janë kontraktuar ose kanë filluar të punohen vite më parë, ngjyrosjen e vijave të bardha pak para se të përurohet asfaltimi në parkingun e QKUK e të tjera si këto", ka theksuar ai. Kelmendi ka thënë se pa vendim-marrje të drejtë dhe transparencë që sjell krijimin e kushteve minimale për punë e kurim, është e kotë lyerja e korridoreve dhe promovimi i sallave nga disa herë, duke përmendur sallën e dytë të Kardiokirurgjisë që u promovua dy herë para se të vihej në punë. "Shumë prej jush jeni përballur dhe ende po përballesh me skena e pasoja të rënda gjatë kurimit aty. Njëjtë edhe mjekët e punëtorët shëndetësorë", shtoi ai para se t'i rendisë problemet për të cilat tha se uron të jenë të fundit me të cilat përballet Qendra Kryesore e Shëndetësisë Publike.



## Policia arrestohen dy persona të dyshuar për mashtrim

**PRISHTINË, 6 GUSHT (ER)** - Njësitë i Hetimeve të Përgjithshme në Prishtinë ka arrestuar dy persona të dyshuar për mashtrim: B. K., mashkull, 29 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës dhe B. E., mashkull, 33 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, të cilët dyshohet të kenë marrë nga persona të ndryshëm shuma të caktuara parash që në total arrijnë vlerën rreth 10 000 euro, duke u premtuar atyre se do t'ua rregullonte dokumentet për të punuar

jashtë vendit. "Mbështetur në rezultate e para të hetimit, policia ka ngritur dyshimin e bazuar se mashtrimi mund të ketë ndodhur në vazhdimësi për një periudhë të gjatë kohore dhe dyshohet se numri i personave të mashtruar nga i dyshuari mund të jetë më i madh sesa numri i raportuar deri tani. Deri tani në polici si viktime të këtij mashtrimi janë paraqitur pesë persona andaj, marrë në konsideratë këtë fakt, kërkojmë nga qytetarët që mund të kenë

qenë viktime e rasteve të tilla të lajmërohen në stacionin më të afërt policor për ta ndihmuar policinë drejt hetimit përfundimtar", ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas këtij njoftimi, pas arrestimit dhe marrjes së autorizimit nga ana e prokurorit, personat e dyshuar janë dërguar në qendrën e mbajtjes në Prishtinë, ku aktualisht hetuesit po kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore e procedurale, para se rasti të kalojë në institucionet kompetente.





## Asfaltohet rruga që lidh dy lagje të Vërmicës

MALISHEVË, 6 GUSHT (ER) - Në kuadër të investimeve në infrastrukturën rrugore në vendbanimet e Komunës së Malishevës, të martën ka filluar asfaltimi i rrugës që lidh dy lagje në fshatin Vërmicë dhe, në të njëjtën kohë, për një rrugë shkurtohet rruga për nxënësit të cilët shkojnë në shkollën e

fshatit, duke mundësuar kështu edhe siguri më të madhe për nxënësit dhe banorët.

Gjatë punimeve për asfaltimin e rrugës në fshatin Vërmicë ishin të pranishëm edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Islam Vrenezi, të

cilët e kanë parë nga afër realizimin e këtij projekti me rëndësi të madhe për banorët e të dy lagjeve. "Kjo ka qenë një kërkesë e hershme e banorëve të lagjeve Ukaj dhe Kastrati. Ne, falë angazhimeve tona për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme, kemi arritur ta realizojmë edhe këtë projekt

dhe besoj se banorët tani janë të kënaqur, pasi kjo rrugë jo vetëm se i lidhë dy lagjet, por edhe e shkurton rrugën për nxënësit", ka thënë kryetari Begaj.

Me këtë rast, Begaj i ka uruar edhe banorët për rrugën e re dhe këtë investim të radhës në fshatin Vërmicë. Drejtori i



Urbanizmit, Islam Vrenezi, ka thënë se kjo rrugë është e gjatë 460 metra dhe ka gjerësi pesë metra.

## Zëvendësministri Kadriu me drejtorin e BERZh-it diskutojnë për zgjerimin e rrugëve regjionale

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturrës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, bashkë me Argjend Zejnaj, shef i kabinetit të ministrit Pal Lekaj, kanë pritur të martën në takim drejtorin e BERZh-it në Kosovë, Neil Taylor. Temë diskutimi e këtij takimi ishte zgjerimi i rrugëve regjionale, me theks të veçantë hyrje-dalja në Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Kllokot, hyrja në Prizren, si dhe mbarëvajtja e projektit Kijevë-Zahaq dhe krijimi i mundësive që punimet të fillojnë sa më parë. "Investimet e huaja në Kosovë, përkrahja e projekteve nga organizata të

rëndësishme botërore si BERZh-i, ndodhin vetëm kur shohin seriozitet në punë dhe qartësi në projekte. Ne po bëjmë përpjekje të vazhdueshme të dëshmojmë vullnet dhe seriozitet për t'i realizuar shumë projekte që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe krejt kjo po ndikon të jemi në vëmendjen e këtyre organizatave. Nuk ka dyshim, Kosova është thuajse në përmbyllje të projekteve kapitale sa i përket infrastrukturës rrugore. Vendi ynë po bëhet i krahasueshëm me vendet e tjera të zhvilluara", ka thënë zëvendësministri Kadriu pas takimit.



## Lladrovci i kërkon ministrit Mustafa rritjen e stafit të qendrës për pajisje me dokumente në Drenas



DRENAS, 6 GUSHT (ER) - Komuna e Drenasit, respektivisht kryetari Ramiz Lladrovci, në ditët e fundit ka pranuar ankesa të ndryshme për vonesat që po bëhen për ofrimin e shërbimeve pranë Qendrës për Pajisje me Dokumente në Drenas. Qytetarët e Drenasit i kanë adresuar shqetësimet dhe pakënaqësitë e tyre në drejtim të komunës duke menduar se kjo qendër është në menaxhim të Komunës së Drenasit.

Komuna e Drenasit është në dijeni se stafi i QPD-së, edhe pse është në menaxhim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe përkundër përkushtimit dhe vullnetit, po

bën përpjekje t'u dalë ballë kërkesave të shtuara të bashkatdhetarëve të cilat gjatë muajve të verës shtohen, por që me kapacitetet aktuale po e përballon me shumë vështirësi e vonesa fluksin e shtuar të kërkesave. Për këtë arsye, kryetari Lladrovci, në respekt të kërkesave të shtuara të bashkatdhetarëve tanë, i ka bërë kërkesë zyrtare ministrit të Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, që t'i marrë masat e nevojshme duke shtuar numrin e stafit, sidomos gjatë verës, në mënyrë që bashkatdhetarët tanë në botën e jashtme të jenë në gjendje të marrin shërbime cilësore brenda një kohe të arsyeshme.

## Në Kamenicë hapet qendra këshilluese për gratë shtatzëna

KAMENICË, 6 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkë me drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Suna Zajmi, dhe përfaqësueset nga Aksioni për Nënën dhe Fëmijën, kanë bërë hapjen e "Klasës për nëna" në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Kryetari Kastrati ka thënë se kjo klasë do të shërbejë si qendër informuese e këshilluese për gratë shtatzëna dhe partnerët e tyre që nga periudha e paralindjes e deri te paslindja e kujdesi gjatë zhvillimit të foshnjës dhe të gjitha grave do t'u jepen falas vitaminat "Prenatal". "Jam shumë i lumtur që sot po bëjmë hapjen e 'Klasës për nëna' në Kamenicë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre

klasave këshilluese dhe ndihmën që e ofrojnë, në bashkëpunim me ambasadën e Zvicrës dhe Aksionit për Nënën dhe Fëmijën po angazhohemi që grave shtatzëna t'u ofrojmë këtë periudhë", ka thënë ai.

Ndërkaq drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Suna Zajmi, ka thënë se kjo klasë është e domosdoshme dhe do të jetë një ndihmesë mjaft e madhe për gratë në periudhën e shtatzënisë dhe pas lindjes. E përfaqësuesja nga Aksioni për Nënën dhe Fëmijën, Albiona Beha, ka theksuar se klasa e hapur sot në Kamenicë është e njëmbëdhjeta në Kosovë dhe, sipas saj, deri më tani 5 000 gra kanë përfituar nga këto qendra këshilluese.



## Rruga "Malësia e Madhe" në Shirokë ka filluar të ndërtohet

SUHAREKË, 6 GUSHT (ER) - Në Shirokë të Komunës së Suharekës ka filluar të ndërtohet rruga "Malësia e Madhe", e cila do të

ketë rëndësi të veçantë për banorët e Shirokës. Për t'i parë punimet në Shirokë ka shkuar kryetari i Komunës së Suharekës,

Bali Muharremaj. "Në Shirokë sot filluam ndërtimin e rrugës 'Malësia e Madhe', e cila do të ketë rëndësi të madhe për banorët. Ne

do të jemi në terren për zbatimin dhe realizimin e projekteve", ka thënë Muharremaj pas vizitës së punimeve.



## ARKEP-i: 'Z-Mobile' të mos vendosë në treg SiM kartela të reja

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Bordi i Autoritetit Rregullativ të komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka pritur të martën në takime të ndara përfaqësuesit e ndërmarrjes publike Telekom i Kosovës sh. a. dhe përfaqësuesit e ndërmarrjes Dardafon.net (Z-Mobile) për t'i kërkuar sqarimet e nevojshme në lidhje me procesin e tranzicionit pas mosvazhdimin të raportit komercial ndërmjet palëve.

Bordi i ARKEP-it është njoftuar nga këto ndërmarrje me veprimet e ndërmarrja deri më tani pas njoftimit për mosvazhdimin e raportit komercial nga Telekom i Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij

procesi si dhe me qëllim të zbatimit të plotë të Kornizës Rregullatore, ARKEP-i ka kërkuar që deri në përfundim të procesit. Palët e përfshira në këtë proces të mosndërmarrin veprime të njëanshme të cilat do të mund ta dëmtonin konsumatorin, me të cilën kërkesë janë pajtuar të dyja palët; Operatori Dardafon.net gjatë kësaj faze të mos vendosë në treg SiM kartela të reja, si dhe të mos hyjë në kontrata të reja me konsumatorët. "Bordi i ARKEP-it do ta njoftojë opinionin me kohë për çdo hap që do të ndërmanë në lidhje me këtë proces të cilin është duke e trajtuar me prioritet të lartë. Pas marrjes së informacioneve shtesë nga operatorët

gjatë ditëve në vijim dhe analizimit të praktikave evropiane, ARKEP-i do të marrë vendime nëse janë të nevojshme në lidhje me këtë proces, sidomos me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së shërbimit për konsumatorët. ARKEP-i në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësisë, të cilat dalin nga Ligji bazë për komunikimet elektronike, mbetet i përkushtuar në vazhdimësi për rregullimin e tregut në kuadër të mandatit që ka dhe mbi bazën e parimeve themelore të cilat garantojnë konkurrencë efektive, transparencë, mosdiskriminim dhe, para së gjithash, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve", është thënë në njoftimin e ARKEP-it.



# Kosova, 'dy' buxhete

Prishtinë, 6 gusht - Arben Imeri nga Kosova ka rreth 23 vjet që jeton me familjen në Londër të Mbretërisë së Bashkuar. Ai për çdo vit viziton prindërit në qytetin e lindjes, Podujevë. Arbeni tregon se për çdo muaj dërgon para për prindërit në Kosovë. Ai thotë se shuma më të mëdha të parave ka dërguar pas përfundimit të luftës, për rindërtim të shtëpisë, kurse tash dërgon të holla çdo muaj. "Përafërsisht 300-400 euro në muaj i dërgoj për prindërit në Kosovë. Tashmë edhe këta (prindërit) gjenden ekonomike e kanë më mirë dhe u ndihmoj më pak. Menjëherë pas përfundimit të luftës kemi dërguar më shumë", ka thënë Imeri.

Nuk është vetëm Arbeni mërgimtar që dërgon para në Kosovë. Vetëm në pesë muajt e parë të këtij viti vlera e remitencave (parave të dërguara nga diaspora), sipas Bankës Qendrore të Kosovës, ka arritur në 332 milionë euro. Kurse vitin e kaluar vlera e remitencave ka tejkaluar shumë prej 800 milionë eurosh, duke shënuar vlerën më të lartë dekadën e fundit. Por, shuma e dërgesave nga diaspora brenda një viti konsiderohet se është edhe më e lartë, pasi një pjesë e mjeteve besohet se hyjnë në Kosovë edhe përmes formave të tjera të cilat mund të mos përfshihen në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës.

Vlerën e remitencave disa nga ekspertët për çështje ekonomike e konsiderojnë buxhet të dytë të Republikës së Kosovës, që ekskluzivisht i takon përmirësimit



të mirëqenies sociale të qytetarëve, për dallim nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës, që në raste të caktuara, sipas tyre, keqpërdoret.

Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" shpreh se burime të rëndësishme të të hyrave dhe stabilitetit social të ekonomive familjare në Kosovë vazhdojnë të jenë dërgesat e emigrantëve. "Kosova ka fat që ka dy buxhete, një buxhet është ai që kalon në Kuvend dhe më shumë është djersë e qytetarëve dhe bizneseve të kosovarëve që, për fat të keq, i gjykojnë për t'u keqpërdorur në veçanti si pasojë e mospërdimit

të rendit dhe ligjit. Kemi edhe një buxhet tjetër që pothuajse është i barabartë e që vjen nga diaspora dhe është garanci e stabilitetit social në Kosovë, një rritje ekonomike në katër për qind, për shkak se dihet që i vetmi indikator është konsumi", është shprehur Gërxhaliu.

Eksperti tjetër për çështje ekonomike, Naim Gashi, ka thënë se vlera e dërgesave nga qytetarët e Kosovës që jetojnë në shtete të ndryshme të Evropës dhe botës është përkrahje financiare për qytetarët, por edhe për ekonominë e përgjithshme të vendit. "Një e treta e buxhetit të Kosovës është e bazuar nga dërgesat e drejtpërdrejtë të diasporës sonë që janë mbi 700 milionë euro dhe mbi 1.3 miliardë euro që llogaritet që janë shpenzime të diasporës gjatë qëndrimit të tyre gjatë verës dhe festave të fundvitit në Kosovë. Kështu që ekonomia e Kosovës pa diasporën do të ishte në gjendje jashtëzakonisht të vështirë. Do të thotë, se diaspora ndikon drejtpërdrejt në rritjen afatgjatë ekonomike për arsye se kjo llogaritet sikur një neto eksport i Kosovës, për vetë faktin se Kosova nuk dërgon mallra dhe shërbime jashtë vendit, mirëpo ekonomia e Kosovës përfiton mjete financiare në vlerë rreth dy miliardë euro", ka thënë Gashi për "Radion

Evropa e Lirë". Bazuar në shënime të zyrtare, janë mes 700-800 mijë qytetarë të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës. Sipas të dhënave Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm në vitin e kaluar rreth 29 mijë qytetarë të Kosovës kanë emigruar në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Kurse përgjatë viteve 2013-2017 nga Kosova, sipas të dhënave zyrtare, kanë emigruar më shumë se 170 mijë qytetarë. Në këto të dhëna është përfshirë emigrimi i rregullt dhe i parregullt dhe se një numër i konsiderueshëm emigruan duke kërkuar azil.

## Hapet ankandi i obligacioneve në vlerë 20 milionë euro

Prishtinë, 6 gusht (ER) - Ministria e Financave (MF) ka njoftuar se më 13 gusht do të mbahet ankandi i dymbëdhjetë me radhë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emeto-

hen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i

përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (dy vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankandë për blerjen e letrave me vlerë,

ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave.





Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (12)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin  
NOVOSELLA**

Lavdi jetës dhe veprës Tënde, o Baca Adem, o Babai i Kombit!

28 korrik 2018,  
R. Gashi

Me Ty Bacë, u rritem e u burrrë-  
am me idealet e larta dhe u  
frëmëzuam nga vepra Jote!  
Lavdia të takon TY, Bacë!

28 korrik 2018,  
Fatmir Arifi

Baca Adem, atëherë edhe kur  
çdo fjalë na e ndaluan, Ti na  
frëmëzove për qëndresë dhe në  
luftë për liri! Shpresoj se filozofia  
e urtë e mendimit tuaj do jetë  
burim i pashtershëm mësimi për  
ne edhe në të ardhmen. Me  
nderime përjetësisht!

28 korrik 2018,  
Hajdin Abazi

Nder dhe respekt veprës heroike  
të kolosit të shqiptarisë, Bacës  
Adem Demaçi! Qoftë i përjet-  
shëm kujtimi për Ty! Të qoftë i  
lehtë dhe i tokës Dardane!

28 korrik 2018,  
Fatmir Sh. Dermaku

Të rrallë janë popujt të cilët kanë  
privilegjin të krenohen me per-  
sonalitetet si ai i heroit Adem  
Demaçi! Ishte fat i kombit shqip-  
tar që në gjirin e tij ta ketë një të  
tillë, si intelektual, aktivist poli-  
tik, shkrimtar e mbi të gjitha si  
burim frëmëzimi e historibërës  
për shumë gjenerata, përfshirë  
edhe ata që do të vijnë pas  
shuarjes biologjike të tij.  
Amaneti i tij do të mbetet oblig-  
im dhe detyrë e të gjithë shqip-  
tarëve, deri në realizimin e të  
drejtës për vetëvendosje!  
Për një komb të bashkuar e të  
fuqishëm shqiptar! Zoti e pastë  
pranuar në mesin e heronjve të  
mirë!

28 korrik 2018,  
Dr. Arbër Vokri

Baca Adem, njeri i paqes dhe biri  
i madh i kombit shqiptar! Zoti të  
mëshiroftë! Amin!

28 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, të gjithë kemi lindur  
dhe do të vdesim, askush përjetë  
nuk ka mbetur! Lumi ti që je për-  
jekur dhe për atdhe ke vdekur!  
Jeni hero i madh i gjithë popullit  
shqiptar! Krenohemi me ty dhe  
betohemi që do të ndjekim rrugën  
tënde!

29 korrik 2018,  
Ejup Dermaku

Duhet të jemi fatlum dhe krenar  
që kemi jetuar në kohën e Adem  
Demaçi! Për këtë, brezat e  
ardhshëm do të na e kenë zili,  
sepse personaliteti si Adem  
Demaçi lind vetëm një herë në  
një mijë vjet, në gjithë rruzullin  
tokësor!

29 korrik 2018,  
Avni dhe Xhemile Dehari

Bacë, me emrin tënd u edukua një  
popull i tërë, për të luftuar për liri  
dhe për të kërkuar të drejtat e veta  
natyrore. Edhe në kohën më të  
vështirë, Ti me mendje e me  
guxim sfidoje çdo pengesë për të  
përmbyllur veprimtarinë tënde  
për çlirim. Ishe gjithmonë përbal-  
lë, në të gjitha shtigjet e luftës për  
liri. Do të mbetesh i madhi i kom-  
bit shqiptar në epokën e pas Luftës  
së Dytë Botërore, deri në çlirimin e  
Kosovës!

Lavdi e përjetshme, Baca Adem!

29 korrik 2018,  
Salihe Salihu

Baca Adem gjeti jetën edhe pas  
vdekjes!

29 korrik 2018,  
Ramizi

Adem, çdo ditë, çdo muaj, çdo vit,  
gjithnjë e më tepër do ta kuptojmë  
vlerën Tënde unike! Je i pari në

këtë botë që tri herë pushtuesit i ke  
thënë: Jo, Jo, Jo! Nuk do të harroj  
kurrë, kurrë, kurrë!

29 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem,  
Heronjtë kanë vetëm ditëlindje. Si  
rreze dielli, fjalët dhe vepra juaj,  
do na ndriçojnë rrugën e do na  
ngrohin zemrën! Lum ne që jetu-  
am në Epokën Tënde!  
Lavdi të qoftë përjetësisht!

29 korrik 2018,  
Vlora Çitaku

Bacë, ishe dhe mbetesh krenaria  
kombëtare! I përjetshëm kujtimi  
për gjithë popullin e Kosovës dhe  
gjithë shqiptarisë. Gjatë do jetojë  
mesazhi Yt: Lira, Bashkimi!...

29 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Shkove fizikisht, por do të jesh i  
përjetshëm me ne, me veprën dhe  
vetëmohimin Tënd! Do të na  
mungosh, por do jetë me ne vepra  
Juaj!

29 korrik 2018,  
Fexhrije Potera - Hisenaj

Lëvizja Popullore e Kosovës, orga-  
nizatë politiko-ushtarake, falë  
rrugës së trasuar nga ideologu  
jonë Adem Demaçi, arriti të vazh-  
dojë rrugën e lavdisë dhe me tri  
luftërat çlirimtare; UÇK, UÇPBM,  
UÇ Kombëtare, solli lirinë të cilën  
e gëzojmë ne sot!  
Lavdi veprës dhe jetës Tënde, o  
Baca Adem!

29 korrik 2018,  
Murat Bytyqi, LPK

Krenaria e popullit shqiptar, jeni

Ju, Baca Adem Demaçi!

29 korrik 2018,  
Arieta Alimusaj

Një jetë kushtuar atdheut, Baca  
Adem Demaçi! Ti ishe frëmëzim  
për gjeneratat e vjetra e të reja, për  
çdo atdhetar liridashës të  
Kosovës! Të qoftë i lehtë dhe i  
Kosovës nënë! Jeta dhe vepra e  
Juaj nuk do të harrohet kurrë!

29 korrik 2018,  
Time Kadrijaj, veterane, UÇK

Lavdi jetës dhe veprës së bacës  
Adem Demaçi, i cili na mësoi  
rrugën e lirisë së kombit. Ne gjith-  
monë do të kujtojmë dhe ndero-  
jmë veprën Tënde. I lehtë të qoftë  
dhe i Kosovës, për të cilën ke  
dhënë kontributin gjithë jetën!

29 korrik 2018,  
Berat Hyseni

Baca Adem, na mungon shumë,  
por në këtë botë ke për të mbetur  
në zemrat tona si një hero i popu-  
lit shqiptar. Iu shprehu ngushël-  
lime familjes suaj. Me respekt të  
thellë për kontributin tuaj jetësor  
për çlirimin e popullit shqiptar!

29 korrik 2018,  
Shqipdona Makolli

Dhembja na goditi për Ty-Hero i  
Kosovës, Lapidar i Lirisë! Respekt  
për jetë e mot për veprën Tënde!

29 korrik 2018,  
Ali Lajçi

Vajzës i lë Emrin ABETARE, se ishe  
mësuesi ynë i parë!  
Djalit i le emrin SHQIPTAR, se  
ishe më i madhi shqiptar!  
Plot respekt dhe i paharruar do  
mbetesh për jetë e mot!

29 korrik 2018,  
Teuta Sejdiu

Unë nuk kam fjalë ta përshkruaj  
madhësinë Tuaj, Baca Adem!

29 korrik 2018,  
I. Kurteshi

Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës, i  
madhi Baca Adem, Ylli mbrojtës i  
popullit shqiptar!

29 korrik 2018,  
Mire Gashi

Baca Adem, si shok i djalit tuaj  
Shqiptarit, pata fatin ta ndiej për  
së afërmi frëmën e rezistencës  
Tënde unike!

29 korrik 2018,  
Dr. Arsim Gërxhaliu

Erdhëm me nderimin e përjet-  
shëm për njeriun që bëri aq  
shumë për popullin, për human-  
istin, vizionarin, syptremburin  
që ishte vetëm, unik - BACA! I  
jemi mirënjohës ne të gjallët dhe  
gjeneratat që do të vijnë, me  
njeriun me të cilin krenohet  
gjithë kombi!

29 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ideja e bashkimit kombëtar jeton  
në përjetësi! Të paçim përjetë  
borxh, Baca Adem!

29 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Punën e Tij, vetëm Zoti e shpër-  
bleftë!

29 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

(Vazhdon në numrin e  
ardhshëm)





E jashtëzakonshme

## "Njeriu i vdekur" shfaqet në ceremoninë e funeralit të tij, tronditen familjarët

Banorët e fshatit Godmiaha në Kenia u tronditën kur një 38-vjeçar që ata besuan se kishte vdekur dhe ishte gati të varroset u rishfaq në ceremoninë e tij të funeralit për të konfirmuar se ai nuk kishte vdekur. Kennedy Olwa u zhduk nga shtëpia rreth dy dekada më parë. 38-vjeçari dëgjoi në radiot lokale lajmin për vdekjen e tij



dhe shkoi në shtëpi për ta informuar familjen se ai është akoma gjallë për t'i ndaluar marrëveshjet e panevojshme dhe të kushtueshme të funeralit.

## BARSOLETA E DITËS



Njeri në një klub nate në Prishtinë, pasi piu tri birra, kërkoi nga kamerieri pagesën.  
 - 50 euro, zotni.  
 - Qysh bre tri birra 50 euro?  
 - Kaq kushtojnë.  
 - Pasi të kam koleg, a ban ma lirë?  
 - Edhe ti punon kamerier a?  
 - Jo, jam hajn si ti.




## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



### Çdo ditë në ora 17:30 "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch



## FOTO E DITES



Anëtarët e forcave speciale saudite performojnë gjatë një aktiviteti ushtarak. /AP/

## E rrallë

## Amerikani hodhi gabimisht kursimet e një jete në koshin e mbeturinave

Një shkujdesje për pak sa nuk i ka kushtuar kursimet e jetës një burri nga Oregoni në ShBA. 23 000 dollarë, të cilat i kishte kursyer ndër vite, i hodhi gabimisht në koshin e mbeturinave. Paratë ndodheshin në një kuti këpucësh. Gjithçka ndodhi të enjten e javës së kaluar dhe burri e kuptoi shumë shpejt çfarë kishte bërë, por ishte vonë.



Kontejneri i mbetjeve të riciklueshme ishte ngarkuar në një kamion dhe ishte nisur drejt Kalifornisë. Ai telefoni menjëherë kompaninë dhe kjo e fundit vuri në dijeni punëtorët e saj, por nuk ishte e lehtë. Por, megjithatë, fati ishte me të. Punëtorët arritën të gjenin të

premtën rutinë me para e cila udhëtoi e paprekur.


Nga dt. 08.08.2019

## "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.



### DASHI

Sot do të pendoheni për disa shpenzime të bëra kohët e fundit


sepse po shikoni që nuk i keni pasur fare të nevojshme.



### DEMI

Të gjithë ju që keni mjaft kohë në dispozicion duhet të filloni të merreni me aktivitete fizike.

filloni të merreni me aktivitete fizike.



### BINJAKËT

Keni përkrahjen e miqve tuaj në çdo hap që doni të bëni.

Ndryshime të mëdha parashikohen për ju dhe jeni stepur disi nga e panjohura.



### GAFORRJA

Sot jeni tipa ëndërrimtarë dhe mendja ju rri vetëm tek momentet e bukura.

Shumë shpejt do të duhet të ktheheni me këmbë në tokë se dita është mjaft e ngjeshur.



### LUANI

Jeni tipa të pavarur dhe do ta shprehni mendimin tuaj edhe me kosto të lartë nga mbrapa.

Kufizimet dhe kornizat nuk janë në stilin tuaj.



### VIRGJERESHA

Edhe pse së fundmi nuk keni mjaft ndërveprim me partnerin kjo gjë nuk ju pengon të bëni plane bashkë.

Ndiheni të dy të lodhur nga rutina.



### PESHORJA

Nëse doni të debatoni me dikë është mirë që ta bëni për situata të së tashmes dhe jo duke sjellë në valle të shkuarën e gjithsecilit.

është mirë që ta bëni për situata të së tashmes dhe jo duke sjellë në valle të shkuarën e gjithsecilit.



### AKREPI

Sot ju ka pushtuar një xheloz e pashpjegueshme që do të ketë pasoja jo të mira në lidhjen tuaj.

Do të merrni të mirëqenë çdo gjë që do ju thuhet.



### SHIGJETARI

Mjaft entuziastë sot në çdo gjë që do t'ju komunikohet.

Ndiheni si fëmijë që po i dhurojnë një lodër që mezi e prisnit dhe doni ta eksploroni.



### BRICJAPI

Kujdes me hapat e gabuar sepse mund t'ju çojnë në një rrugë pa krye.

Ndonjëherë bëni mirë të kërkoni ndihmë kur jeni në kohë.



### UJORI

Nuk lejoni askënd të prekë parimet tuaja dhe për këtë gjë jeni mjaft krenare.

Por të tjerët do ta keqinterpretajnë këtë virtyt që keni.




### PESHQIT

Kjo ditë do të nisë me ide të reja që doni t'i vini sa më shpejt në zbatim.

Do të kuptoni që nëse gjërat nisin mbarë finalizimi do të jetë shumë i shpejtë.





EURO GLASS  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Feronikeli dhe gjashtë klubet e tjera ndërrojnë trajnerët

Shtatë nga dymbëdhjetë klubet e Superligës së Kosovës në futboll kanë bërë ndryshime në pozitat e trajnerit, kurse risia më e madhe është emërimi i Dejan Vukiqeviqit në krye të skuadrës së Feronikelit. Ish-lojtari i Sevillas dhe Partizanit të Beogradit është prezantuar të martën si trajner i kampionëve në fuqi, ndërsa në Superligë do të debutojë trajneri vendor Shpëtim Idrizi, ish-kapiten legjendar i Trepçës '89

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 GUSHT - Pushimi veror ka sjellë ndryshime të shumta në shtabet teknike të skuadra elitare në futbollin e Kosovës. E fundit që ka emëruar trajner të ri është Feronikeli nga Drenasi. Kampionët në fuqi të Kosovës e zëvendësuan Zekirija Ramadanin me Dejan Vukiqeviqin, i cili ka një karrierë të pasur si futbollist dhe si trajner. "KF Feronikeli ka arritur marrëveshje me trajnerin Dejan Vukiqeviq. Ai ka qenë futbollist i shumë skuadrave të njohura si Budućnost/Mogren/Budva, Partizan/Beograd, Sevilla/Spanjë, Larnaca/Qipro. Vukiqeviq ka qenë po ashtu trajner i shumë skuadrave të njohura si Zeta/Podgorica, Mogren/Budva, Mladost/Podgorica, Vojvodina/Novi Sad, Dacia Chisinau/Moldova dhe, në fund, në kampionatin paraprak 2018/2019, ishte trajner i skuadrës Ventpils/Latvia", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Marrëveshja në mes të trajnerit malazez dhe "Niklit" është njëvjeçare, kurse të martën pasdite trajneri ka qenë i pranishëm në stërvitjen e skuadrës së Feronikelit.

Një ditë më herët se Feronikeli trajnerin e ri e ka prezantuar edhe skuadra e Ferizajt. Kjo e fundit në vend të Bylbyl Sokolit të larguar e ka emëruar Bekim Isufin, i cili vlerësohet si një nga trajnerët më të mirë në vend. Isufi në edicionin 2017/2018 e kishte shpallur Dritën kampione e më pas me këtë skuadër mori pjesë në garat ndërkombëtare. "Bordi udhëheqës i klubit futbollistik 'Ferizaj' arriti marrëveshjen me trajnerin e mirënjohur Bekim Isufi për ta drejtuar skuadrën tonë, në kampionatin futbollistik 2019/2020", thuhet në njoftimin e KF Ferizaj.

Njëjtë ka vepruar edhe skuadra e Trepçës '89. Mitrovicasit nuk janë



paraqitur mirë në edicionin e fundit dhe në edicionin e ri detyrën e trajnerit ia kanë besuar Shpëtim Idrizit, i cili ishte kapiten për shumë vite dhe shtyllë e skuadrës nga "Riza Lushta". Ndërsa ndryshime në shtabin teknik ka bërë edhe Ballkani i Suharekës. Kjo skuadër nuk arriti marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit me trajnerin Gani Sejdiu dhe në vend të tij e ka emëruar Ismet Munishin. Një ndryshim të papritur e ka bërë edhe skuadra e Flamurtarit, e cila, edhe pse pati rezultate të mira nën drejtimin e Arsim Thaqit, vendosi që pasardhës i tij të jetë Artim Shaqiri, ish-reprezentuesi i Maqedonisë Veriore dhe futbollist i Premierë Ligës.

Ndryshime në shtabet teknike kanë

bërë edhe dy skuadrat e inkuadruara në IPKO Superligë, Vushtrria dhe Dukagjini i Klinës. Klubi nga Vushtrria në vend të Samuel Nikajt e emëroi Bekim Shotanin, kurse Dukagjini i Klinës e ka emëruar trajner Xhengiz Rexhepin, i cili në edicionin e kaluar e drejtoi skuadrën e Llapit. Ndërsa të paprekshëm ishin pesë trajnerë, duke nisur nga Mirel Josa i Prishtinës, më pas Tahir Batatina i Llapit, por edhe Tahir Lushtaku i Drenicës. Dy skuadrat e tjera që iu besuan trajnerëve paraprakë ishin skuadrat nga qyteti i Gjilanit, Drita dhe Gjilani. Ardian Nuhiu do të vazhdojë punën me Dritën, kurse Gentian Mezani me Gjilanin.

SHKURT

## Veseli prezantohet te Rahoveci

KB Rahoveci vazhdon përforcimet për edicionin e ri. Basketbollisti i njohur Alban Veseli është përforcimi i radhës për këtë klub që synon trofe në edicionin e ri basketbollistik. Në të kaluarën Veseli ka luajtur edhe për Prishtinën, Yllin dhe Pejën.

## Llapi prezanton Argjend Mustafën

Mesfushori Argjend Mustafa është futbollist i ri i skuadrës së Llapit. Prezantimi i tij është bërë të martën nga skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina, kurse një ditë më parë mesfushori shkëputi kontratën me Prishtinën. "Mesfushori ofensiv nuk ka pasur shumë dilema në përzgjedhjen për edicionin e ri dhe pa hezitim ka pranuar ofertën e Llapit për edicionin e ri të Superligës. Ai ka përvijë në futbollin e Kosovës dhe të Shqipërisë. Mustafa ka luajtur për skuadrën e Trepçës e të Trepçës '89. Më pas u transferua te Skënderbeu i Korçës. Pasi përfundoi edicionin me Prishtinën me 29 paraqitje dhe dy asistime, Argjend Mustafa është i gatshëm për një aventurë të re pikërisht me Llapin drejt titullit kampion dhe daljes në Evropë", thuhet në njoftimin e Llapit.

## Koscielny lë Arsenalin, transferohet në Bordeaux

Mbrojtësi Laureat Koscielny është larguar zyrtarisht nga Arsenalin për të kaluar në Francë te Bordeauxi. Qendëmbrojtësi që ishte kapiten i Arsenalit ka pasur 353 paraqitje për "Topçinjtë" që kur iu bashkua më 2010 nga Lorienti. Arsenalin ka fituar rreth 5 milionë funte nga transferimi i Koscielnyt në Bordeauxin.

## Pensionohet Mazrekaj

Ish-futbollisti i Prishtinës dhe Partizanit, Mentor Mazrekaj, i ka dhënë fund karrierës si futbollist që në moshën 30-vjeçare. Lajmin e ka publikuar vetë futbollisti në profilin e vet në "Facebook". "Miqte e mirë, sot kam marrë vendimin më të vështirë deri me tani në jetën time. Nga sot kam vendosur mos të luaj më futboll. Mosprofesionalizmi i duhur, gabimet e shumta në karrierë si dhe lëndimet më shtynë ta marr këtë vendim. I falënderoj të gjithë ata që iu ka pëlqyer loja ime dhe janë argëtuar", ka shkruar Mazrekaj në "Facebook".

## Sonte Kosova përballlet me Britaninë e Madhe

PRISHTINË, 6 GUSHT - Basketbollistët e Kosovës të mërkurën në "Minatori" të Mitrovicës do ta zhvillojnë ndeshjen vendimtare ndaj Britanisë së Madhe në parakual-

ifikimet e "Eurobasket 2021". "Dardanët" janë të motivuar për këtë sfidë dhe nuk dorëzohen pavarësisht prej humbjes nga Luksemburgu. Fitorja do t'u ndihmonte shumë, derisa më 14

korrik, prapë në "Minatori", e presin Luksemburgun. Lojtarët kanë nevojë për përkrahje në njërin nga palestret 'më të xehta' në Kosovë. Ndeshja fillon nga ora 20:30, kurse tifozët e

Kosovës, "Dardanët", kanë konfirmuar praninë e tyre në palestër. Basketbollistët më shumë se kurrë kanë nevojë për përkrahjen e tifozëve në përballjen vendimtare.





## Sot fillon faza e dytë, përballen Kosova - Ukraina

PRISHTINË, 6 GUSHT - Sot (e mërkurë) fillon faza e dytë e grupeve. Dy vendet e para nga faza e parë e grupeve kanë formuar dy grupe të reja, me nga katër ekipe. Dy përfaqësueset e para të

grupit do të luftojnë për t'u kualifikuar në gjysmëfinale. Kroacia, Izraeli, Irlanda dhe Britania e Madhe janë në njërin grup, derisa në tjetrin janë: Turqia, Rumania, Finlanda dhe Bullgaria.

Kosova është në grup me Islandën, Ukrainën dhe Greqinë. Këto kombëtare luftojnë për pozitën 9-12. Fillimisht Kosova të mërkurën do të përballlet me Ukrainën, më pas me

Islandën të premten dhe të dielën ndeshjen e fundit ndaj Greqisë. Të dielën përfundon Evropiani në Prishtinë, kur zhvillohet ceremonia mbyllëse dhe finalja.



## FFK-ja mban ligjërata për klubet kundër kurdisjeve

PRISHTINË, 6 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës përmes Zyrës për Integritet të Garave ka nisur mbajtjen e ligjëratave kundër kurdisjeve të ndeshjeve dhe dukurive të tjera negative me klubet e Superligës dhe Ligës së Parë. Në këto takime është bërë edhe promovimi i broshurës "Ta ruajmë integritetin e futbollit".

Zyrtari për integritet të garave në FFK, Ejup Osmani, gjatë këtyre ligjëratave ka kërkuar nga futbollistët të jenë syçelë dhe të mos bëhen 'argatë' të manipuluesve dhe njerëzve të lidhur me mafinë që synojnë prishjen e 'fair-play'-t në futboll. Më tutje, Osmani ka shpjeguar se paratë e këtyre manipuluesve vijnë nga rrugë të pista dhe krimet prandaj, sipas tij, të gjithë duhet të jenë të vëmendshëm dhe të raportojnë çdo përpjekje të përfituesve të tillë që synojnë t'i joshin futbollistët, gjyqtarët apo drejtuesit e klubeve për kurdisje të ndeshjeve. Teksa ka thënë



se FFK është e vendosur ta mbrojë integritetin e garave dhe ka njerëz që angazhon në mbikëqyrjen e secilës ndeshje, Osmani ka kërkuar nga futbollistët që ta japin kontributin e tyre duke u thënë

"jo" manipuluesve potencialë, duke e raportuar çdo rast në këtë zyrë. Ligjëratat e tilla do të vazhdojnë të mbahen me të gjitha klubet si dhe me delegatët e gjyqtarët e ndeshjeve.

## Tragjedi në çiklizëm, ndërrojnë jetë Bjorg Lambrecht

CHORZOW, 6 GUSHT - Bota e çiklizmit është në zi. Është ndarë nga jeta, gjatë Turit të Polonisë, në moshën 22-vjeçare, çiklisti belg Bjorg Lambrecht, pas një aksidenti të pësuar në etapën e tretë të kësaj ngjarjeje. Lajmin e hidhur e dhanë drejtuesit e skuadrës së tij Lotto Soudal në rrjetin social "Twitter". "Ndodhi tragjedia më e madhe për familjen, miqtë dhe shokët e skuadrës së Bjorg. U prehtë në paqe!", shkruhej në postimin e Lotto Soudal.

Mësohet se Lambrecht u rrëzua në një kanal kur kishin mbetur 70 km nga fundi i etapës dhe ende nuk dihet shkaku nëse ka qenë terreni i lagur nga reshjet apo gjendja jo e mirë e çiklistit. Pas rrëzimit, Lambrecht iu dha menjëherë ndihma, por shumë shpejt u verifikua që gjendja e tij ishte kritike dhe e pamundur të dërgohej në spital me helikopter, kështu që transportimi i tij u bë me ambulancë. Mjekët u përpoqën ta mbanin në jetë, por tentativat e tyre rezultuan të kota. Ndërkaq, shokët e tij të skuadrës së Lotto Soudal me Caleb Ewan në krye nëpërmjet rrjeteve sociale shprehën hidhërimin e tyre për ndarjen nga jeta të talentit 22-vjeçar. Bjorg



Lambrecht shihej si e ardhmja e çiklizmit belg teksa vitin e kaluar ai fitoi medaljen e argjendtë në botërorin e të rinjve në Innsbruck.

Turi i Polonisë ishte një përgatitje për të për pjesëmarrjen në Xhiron e Spanjës që ishte edhe objektivi madhor i tij.

### SHKURT

#### Juve ofron tre lojtarë për Pogban

Mesfushori i Manchester Unitedit, Paul Pogba, vazhdon të jetë mjaft i kërkuar nga Real Madridi dhe Juventus. Mediet italiane të martën kanë raportuar se "Zonja e Vjetër" është e gatshme të ofrojë tre lojtarë për ta rikthyer sërish Pogban në Torino. Bëhet fjalë për Mario Mandzukiqin, Paulo Dybalan dhe Blaise Matuidin. Në anën tjetër trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka konfirmuar se mesfushori francez nuk do të largohet nga "Old Trafford".

#### Ribery në Arabinë Saudite

Franck Ribery e ka marrë vendimin në lidhje me të ardhmen e tij. Mesfushori ofensiv u largua nga Bayern Munchen pas plot 12 vjetëve, periudhë ku fitoi gjithçka. Francezi e mbylli aventurën franceze me 24 trofe të fituar, nga të cilat nëntë tituj kampionë, duke vendosur një rekord për fitimin e Bundesligës. 36-vjeçari pritet të transferohet në Arabinë Saudite. "Kicker" raporton se një ofertë e majme ka ardhur nga Al-Nassr Riad. Dy vjet kontratë i ofron klubi arab Riberys, i cili pritet ta pranojë këtë ofertë dhe të nisë një aventurë të re në karrierën e tij.

#### Crystal Palace transferoi Cahillin

Crystal Palace ka arritur marrëveshje me ish-mbrojtësin e Anglisë dhe Chelseat, Gary Cahill për një kontratë dyvjeçare. 33-vjeçari u lirua nga Chelsea në fund të edicionit të kaluar. Ish-mbrojtësi i Boltonit dhe Aston Villas regjistroi 61 paraqitje me fanellën e Anglisë para se të pensionohet nga futbollit ndërkombëtar në gusht të vitit 2018. Pas Stephen Henderson dhe Jordan Ayew, Cahill është transferimi i tretë i Crystal Palaces në këtë afat kalimtar.

#### Ziyechi në 'radar' të Bayernit

Pas largimit të De Ligt drejt Juventusit, De Jongut drejt Barcelonës si dhe me Van de Beek që duket se është pranë Real Madridit, eksodi i lojtarëve në shtëpinë e Ajaxit mund të vazhdojë. Emri i radhës që mund të largohet është talenti maroken Hakim Ziyech. 26-vjeçari po ndiqet me shumë interes nga Bayern Munchen, i cili nga ana tjetër po ndjek edhe Leroy Sane. Por duke parë vështirësitë për të arritur pikërisht te lojtari i Manchester Cityt, duket se drejtuesit bavarezë kanë gjetur alternativën e duhur, pikërisht Ziyech.

#### Van Dijk paralajmëron Maguiren: Do të kesh shumë presion

Harry Maguire u ble nga Manchester Unitedi për 80 milionë paund, duke u bërë mbrojtësi më i shtrenjtë në botë. Fronin deri dje e mbante Virgil van Dijk, të cilin Liverpools e bleu për 75 milionë paund para dy vjetësh te Southampton. Gjithsesi mbrojtësi holandez ka një mesazh të qartë për anglezin, që nuk e shikon më si rival, por e këshillon si koleg dhe si një njeri që e ka provuar të jetë në qendër të vëmendjes për shkak të çmimit. "Çmimi vjen me presion, por nuk ndryshon shumë sepse gjithmonë keni presion në klube të mëdha si Manchester United. Nuk është e lehtë ta zhdukësh plotësisht presionin. Shumë gjëra janë më të rëndësishme sesa të luash futboll. Duhet ta shijosh, por presioni do të jetë gjithmonë aty. Vetëm përqendrohuni në atë që doni të bëni dhe luani lojën tuaj më të mirë. Tregoni cilësitë tuaja në fushë, shijojeni lojën tuaj dhe mos mendoni për gjërat e tjera. Nëse kundërshtarët lëvizin gjatë ndeshjes sepse ju kushtoni shumë, çfarë mund të bëni? Unë nuk i dëgjoj ata. Kjo nuk ndryshon asgjë në kokën time", ka thënë Van Dijk.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja /Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme  
 Departament za Financije i Opste Sluzbe  
 Department of Finances and General Services

**Bënë**  
**SHPALLJEN E KONKURSIT**

**Titulli i pozitës:** Asistent/e administrativ/e 3 ( një pozitë)  
**Ref:** DP-09/193 - AD/200 / JP00040031  
**Njësia Organizative :** Divizioni i Prokurimit  
**Vend i punës:** Prishtinë  
**Kategoria funksionale:** Niveli Profesional  
**Koeficienti/ grada:** 6 grada 12  
 Lloji i pozitës : E karrierës

**Qëllimi i vendit të punës:**

Sigurimi i mbështetjes për deponimin dhe mirëmbajtjen e mallit si dhe shpërndarjen e tij tek njësitë organizative të institucionit.

**Detyrat kryesore:**

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, dhe e-malit për mbikëqyrësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së Prokurimit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Mban kontakte në emër të Prokurimit me punonjësit e institucionit, zyrtarë të lartë dhe publikun duke përfshirë këtu ofrimin e ndihmës dhe këshillave e udhëzimeve për çështje të caktuara ose shkëmbim të informatave;
- Pranon fatura dhe materiale të ndryshme nga OE, si dhe bën regjistrimin e tyre, gjithashtu bënë regjistrimin e të gjitha urdhër blerjeve.

**Shkathtësitë e kërkuara:**

- Shkolla e mesme me 3 vite përvojë pune;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, )

**Data e shpalljes së konkursit: 07.08.2019**

**Data e mbylljes së konkursit: 21.08.2019**

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve kosovare.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

**Procedura e Aplikimit:** Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Divizionin e Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ndërtesa e Ish Partive Politike në Prishtinë, nr.237 - 240 kati II zona C.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja /Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme  
 Departament za Financije i Opste Sluzbe  
 Department of Finances and General Services

**OBJAVLJIVANJE KONKURSA**

**Naziv pozicije:** Administrativni asistent 3 ( jedna pozicija)  
**Ref:** DN-3 - AD/200 / JP00040031  
**Organizaciona jedinica :** Divizija Nabavke  
**Mesto rada:** Priština  
**Kategoria funksionale:** Profesionalni nivo  
**Koeficienti/ grada:** 6 grada 12  
 Vrsta pozicije : Karijera

**Svrha radnog mesta:**

Pruzanje podrške za skladištenje i održavanje robe i njihove distribucije u organizacionim jedinicama institucije.

**Glavni zadaci:**

- Pruža opštu administrativnu i tehničku podršku uključujući službenu poštu, telefonske pozive, skeniranje, faksiranje i kopiranje dokumenata, popunjavanje izveštaja i sastavljanje dokumenata za razne sastanke;
- Priprema i modifikuje dokumente uključujući prepisku, izveštaje i e-Email za nadzornog;
- Prima i distribuira korespondenciju za nadzornog i brine se o njegovom napretku;
- Čuva i održava elektronski sistem i fizičke kopije dokumenata i datoteka Kancelarije za nabavku
- Upravlja kalendarom sastanaka i drugim događajima za Nadzornog i pomaže u rešavanju svih administrativnih i tehničkih problema;
- Obavlja druge dužnosti u skladu sa zakonima i propisima koje nadzornik može s vremena na vreme tražiti;
- Održava kontakte u ime Nabavke sa osobljem institucije-ustanove, visokim zvaničnicima i javnošću, uključujući pružanje pomoći i saveta u vezi sa određenim pitanjima ili razmenu informacija.
- Prima fakture i drugi materijal od EO i vrši njihovu registraciju, takode vrši registraciju svih narudžbenica.

**Potrebne veštine:**

- Srednja škola sa 3 godine radnog iskustva
- Sposobnost primene administrativnih procedura i uputstava za obavljanje radnih zadataka
- Komunikacijske veštine, uključujući sposobnost tumačenja informacija, pružanja smernica i prenošenja informacija drugima;
- Sposobnost koordinacije i nadzora rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou;
- Računarske veštine u softverskim programskim aplikacijama (Word, Excel,)

**Datum objavljivanja konkursa: 07.08.2019**

**Datum zatvaranja konkursa : 21.08.2019**

Kosovska Državna Služba služi svim ljudima na Kosovu i dobroočekuje aplikacije muškaraca i žena svih kosovskih zajednica.Nepotpune prijave neće se razmatrati. Samo kandidati koji ulaze u izabranu listu biće obavešteni.

Dokumenti bi trebali biti fotokopije u suprotnom neće biti vraćeni.

**Procedura za Aplikiranje:** Obrazac za prijave se može dobiti i dostaviti u Diviziji osoblja u Ministarstvu Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja, bivšoj zgradi političkih stranaka u Prištini, br. 237-240. Sprat II C zona.





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



Datë: 07. 08. 2019

**NJOFTIM PËR REKRUTIM**

Ne pajtim me nenin 11 te Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës si dhe nenin 15 te Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil , Administrata Tatimore e Kosovës bënë rishpalljen për rekrutim për pozitën e punës:

**Titulli i pozitës:** Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike(2 pozita)

**Numri i referencës:** TIK/250/JP00040114

**Përgjegjësi mbikëqyrëse:** Jo

**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit

**Koeficienti:** Tetë (8.0) plus shtesat e aplikueshme

**Afati i emërimit:** Nëpunës i karrierës(përherëshëm), periudha provuese: Dymbëdhjetë(12) muaj.

**Vendi i punës:** Departamenti i Teknologjisë Informativë - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë

**Oëllimi i vendit të punës:**

Analisti/zhvilluesi i aplikacioneve te punës kryen zhvillime kërkimore dhe bën rekomandime nga ana teknike mbi produktet, shërbimet, protokollet dhe standardet e aplikacioneve te punës. Analisti zhvillon, implementon dhe mirëmban kontrollin mbi ndryshimet dhe proceset testuese aplikimin e ndryshimeve apo integrimin e aplikacioneve. Planifikon dhe krijon arkitekturën dhe modelet e aplikacioneve ne bashkëpunim me stafin zhvillues të aplikacioneve. Nën drejtimin e menaxherit vlerëson dhe zhvillon objektivat strategjike për zhvillimin e aplikacioneve, si dhe performancën e tyre deri te përpunimit e proceseve themelore.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Zhvillon dhe implementon aplikacionet e reja, sistemet softuerike - programet, dhe/ose përmirësimin e aplikacioneve ekzistuese në kuadër të ATK-së.
- Sigurohet që aplikacionet e zhvilluara përbushin kërkesat dhe objektivat e biznesit, të përbushë kërkesat e shfrytëzuesve të fundit, identifikon dhe zgjidhë problemet/çështjet e sistemeve.
- Siguron dizajnin, implementimin dhe testimin e softuerit të zhvilluar, përcjellë praktikën dhe standardet e softuerit në bazë të kërkesave te punës në organizatë
- Merr pjesë aktive në fazat para-testuese të zhvillimit duke vlerësuar propozimet me qëllim të identifikimit të fushave potenciale për probleme dhe bën rekomandimet e duhura.
- Ne koordinim me analistët, dizajnerët/arkitektët dhe pronarët të sistemeve, realizon testimet e aplikacioneve dhe programeve të reja softuerike.
- Planifikon, çekzon dhe menaxhon integrimin e aplikacioneve të reja në sistemet ekzistuese dhe softuerëve në kuadër të ATK-së.
- Koordinon punën me administratorët e sistemit, administratorët të rrjetit dhe me administratorët të bazës të të dhënave, të sigurojë funksionim të plotë të infrastrukturës dhe për të asistuar në sigurimin e kualitetit/cilësisë, logjikën e programeve dhe procesimin e të dhënave.
- Identifikon dhe krijon procedura për azhurnimin e aplikacioneve dhe rregullimin/evitimin e problemeve (bug fix).

**Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:**

- Diplomë univercitare në fushën e Teknologjisë Informativë.
- Së paku 3 vite përvojë pune në: C#, ASP.Net MVC, Web Services, Microsoft Office SharePoint Server (MOSS) 2013.
- Njohuri të politikave, operimeve dhe procedurave të ATK-së dhe aftësi për të përdorë atë njohuri për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve në shërbime, sisteme, procese dhe staf
- Përvoja që kanë të bëjnë me sistemin e bazës së të dhënave MS SQL Server apo Oracle.
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, ndër-personale dhe komunikative me aftësi për t'u marrë në mënyrë profesionale me menaxhmentin e lartë dhe personelin e ATK-së në të gjitha nivelet e brendshme dhe me organizatat jashtë ATK-së;
- Aftësi për të menduar në mënyrë strategjike në zhvillimin e zgjidhjeve për çështje që dalin gjatë ccursisë së zhvillimit të projektit apo implementimit;
- Kupton zhvillimin strategjik të ATK-së dhe aplikimin e strategjisë.
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në ambient ekipor
- Nivel të lartë në iniciativën dhe përkushtimin, aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe fleksibilitet, puna ekipore dhe përvojë ne projekte.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar.
- Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente);

**Paraqitja e kërkesave:**

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme te Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuarat së bashku me kopje të dëshmiave të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë ne Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve (diplomave, certifikatave të trajnimeve, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit).

Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.

**Njoftimi do të jetë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 15 ditë nga dita e publikimit, nga data 07.08.2019 deri me datë 21.08.2019 .**

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi te barabarta te punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjimisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet ne Kosove.

"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë te drejte për përfaqësim te drejte dhe proporcional ne organet e shërbimit civil te administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet ne nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës".

Aplikacionet e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do te refuzohen.

Per shkak te numrit te madh te kerkesave te pranuar, vetem kandidatet e perzgjedhur ne listen e ngushte do te kontaktohen.

Per informata shtesë mund te kontaktoni ne numrin e tel. 038/200 34 706.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



Datum: 07.08.2019

**OBAVEŠTENJE O ZAPOSŁJAVANJU**

U skladu sa članom 11 Zakona br. 03/L-149 za civilne službenike Republike Kosovo, kao i članom 15 Uredbe br. 02/2010 za procedure zapošljavanja u civilnoj službi, Poreska administracija Kosova/Divizija humanih resursa objavljuje oglas za zapošljavanje za ovo radno mesto:

**Naziv radnog mesta:** Viši programer i administrator softverskih sistema(2 pozicije)

**Br.referenca radne pozicije:** TIK /250 / JP00040114

**Nadzorna odgovornost:** Ne

**Pozicija:** Pozicija karijere

**Koeficijent:** Osam (8.0) ,plus primenljivi dodaci

**Rok za imenovanje:** Probni rad u trajanju od 12 meseci

**Mesto rada:** Odeljenje za informacionu tehnologiju Generalna direkcija-Prishtina

**Svrha radnog mesta:**

Analitičar/ programer poslovnih aplikacija obavlja istraživačke razvoje i daje tehničke preporuke o proizvodima, uslugama, protokolima i standardima poslovnih aplikacija. Analitičar razvija, implementira i održava kontrolu nad promenama i probnim procesima, primenjuje promene ili integracije aplikacija. Planira i kreira arhitekturu i modele aplikacija u saradnji sa osobljem za razvoj aplikacija. Pod rukovodstvom menadžera ocenjuje i razvija strateške ciljeve za razvoj aplikacija, kao i njihove performanse do obrade osnovnih procesa.

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Razvija i implementira nove aplikacije, sistemi sa softverom - programe i / ili unapredjenje postojećih aplikacija u okviru PAK.
